



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12 Korrik 2021

Nr: 426

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE
KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR), TË CILËT DO TË KRYEJNË
AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA SUBJEKTET
ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”

VËREJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë, transparencës së procesit, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 14, datë 9.6.2021, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, më datë 10.6.2021 deri më datë 29.6.2021, shpalli njoftim publik në faqen zyrtare, për të gjithë personat e interesuar që mabjnë titullin ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), për të marrë pjesë në procesin e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë depozituar dokumentacionin 19 (nëntëmbëdhjetë) aplikantë të interesuar, që mbajnë titullin ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Komisioni i Posaçëm i ngritur për verifikimin e plotësimit të kritereve formale të aplikantëve për auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021 dhe



procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe në bazë të vlerësimit të nevojave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përzgjedhi aplikantët të cilët plotësonin kriteret e përcaktuara.

Më datë 12.7.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin online për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Organizimi i shortit u bë si më poshtë:

Emrat e subjekteve zgjedhore dhe ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) u shënuan në letra të veçanta dhe pasi u lexuan të gjithë, para kamerave dhe mikrofonit, respektivisht u vendosën 32 (tridhjetë e dy) emrat e subjekteve zgjedhore në një enë transparente dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) emrat e ekspertëve kontabël të licensuar në një enë tjetër transparente.

Duke qenë se janë 32 (tridhjetë e dy) subjekte zgjedhore (parti politike dhe kandidat të pavarur) dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), të përzgjedhur, ndarja u bë 13 (trembëdhjetë) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) do auditojnë nga 2 (dy) subjekte zgjedhore dhe 6 (gjashtë) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) do auditojnë nga 1 (një) subjekt zgjedhor.

Përzgjedhja u bë duke tërhequr nga njëra enë transparente emrin e ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor) dhe nga ena tjetër transparente emrin e subjektit zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, nenit 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

V E N D O S :

1. Të miratojë rezultatin e shortit dhe të emëroj ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021, si më poshtë:

1. Neshat MAZE

- a) Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë;
- b) Partia Nisma Thurje.

2. Enkelejda ALITE



- a) Iljaz Shehu;
- b) Partia Socialiste e Shqipërisë;

3. Erjon SARAÇI

- a) Partia Fryma e Re Demokratike;
- b) Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;

4. Fatime ALLIU

- a) Boiken Abazi;
- b) Partia Bashkimi Liberal Shqiptar;

5. Violeta MULLA

- a) Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- b) Partia Lëvizja e Legalitetit;

6. Sherife HOXHA

- a) Partia Emigracioni Shqiptar;
- b) Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;

7. Silvana GJIKDHIMA

- a) Partia Bindja Demokratike;
- b) Partia Lëvizja e Re;

8. Fatmira (SYKJA) KASTRATI

- a) Partia Ora e Shqipërisë;
- b) Partia Balli Kombëtar Demokrat;

9. Meri LIKA

- a) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- b) Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare;

10. Ludmilla PALUKA

- a) Partia Kristian Demokrate;
- b) Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;

11. Eneida RAHMANI

- a) Partia Lëvizja për Ndryshim;
- b) Elton Debreshi;

12. Aida MALOKU



- a) Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- b) Kreshnik Merxhani;

13. Anida NURI

- a) Partia Demokratike e Shqipërisë;
- b) Pal Shkambi;

14. Vullnetare HOXHA

- a) Partia Balli Kombëtar

15. Lejla (Shahu) DOBI

- a) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;

16. Anita PULAJ

- a) Partia Republikane Shqiptare;

17. Margarita KALEMASI

- a) Partia Aleanca Demokracia e Re;

18. Eftali QIRJAQI

- a) Partia SocialDemokrate e Shqipërisë;

19. Hidajete KRAJA

- a) Partia Demokristiane e Shqipërisë.

2. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor) do të paraqesin pranë KQZ-së raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet politike për fushatën zgjedhore 2021, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

